

90 13.9.23.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3418

Nr. \_\_\_\_\_ Prot \_\_\_\_\_

Peshkopi, më 12/09/2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.95

Datë: 07.09.2023

“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga  
Këshilli i Qarkut Dibër”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli



Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: [bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) tel: 0035521822935

Kapja  
2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT DIBËR**

3618/16/09/23

Nr.921/1 prot.

Peshkopi, më 13.09.2023

**Tema :** Mbi verifikimin e ligjshmerise te vendimit nr. 95 date 07.09.2023

**Drejtuar: BASHKISË DIBER**

**DIBER**

Në mbështetje të ligjit nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit të bashkisë Diber, Nr 95, date 07.09.2023 "Për një ndryshim fondesh ne buxhetin e Qendres Kulturore Diber akorduar nga Keshilli i Qarkut Diber në buxhetin e 2023", konstatova se;

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të ligjit per menaxhimin e buxhetit, ligjit 68/ 2017 " Për financat e veteqeverisjes vendore" dhe normave juridike perkatese të cilat rregullojne transferimin e fondeve brenda grupeve ne buxhet, eprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrative-ligjore e strukturave të posaçme të bashkisë Diber që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

**P R E F E K T I**  
**- Nexhbedin SHEHU -**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR  
VENDIM

Nr. 95 Datë 07 / 09 /2023

**“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12.20222, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 19/1 prot, datë 11.01.2023, i ndryshuar, si dhe vendimin nr.16 datë 19.07.2023 të Këshillit të Qarkut Dibër. “Për miratim ndryshim zërash buxhetor dhe transferim fondi për Bashkinë Dibër, (Qendra Kulturore Dibër), për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, konfirmim nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.761/1 datë 24.07.2023, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **07.09.2023**, me 22 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Dibër për Qendrën Kulturore Dibër në vlerën prej 540.000 lekë për pjesëmarrjen e ansamblit të Qendrës Kulturore Dibër në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2023.

**Të pakësohet:**

Gr.00 Tit.1110 Kap.5 Llog. Ekonomike 604 540.000 lekë

**Të shtohet:**

Gr. 00 Tit.8220 Kap.5 Llog.Ekonomike 602 540.000 lekë

- Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
- Vendimi u shpall me datë **07.09.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irini Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA DIBËR  
DREJTORIA EKONOMIKE  
Sektori i finances  
PROJEKT – VENDIM  
Nr. 22 Datë 01/05/2024

**“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr. 120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.19/1 prot. datë 11.01.2023, i ndryshuar, si dhe vendimin nr .16 ,datë 19.07.2023 të Këshillit të Qarkut Dibër “Për miratim ndryshim zërash buxhetor dhe transferim fondi për Bashkinë Dibër, (Qendra Kulturore Dibër), për zhvillimin e aktiviteteve kulturore,konfirmim nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën.761/1 prot. date 24.07.2023,

**Kërkojmë:**

- Miratimin e fondit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Dibër për Qendrën Kulturore Dibër në vlerën prej 540,000 lekë për pjesëmarrjen e ansamblit të Qendrës Kulturore Dibër në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2023.

Të pakësohet:

GR.00 Tit. 1110 Kap. 5 Llogaria ekonomike 604 540,000 lekë

Të shtohet:

GR.00 Tit. 8220 Kap. 5 Llogaria ekonomike 602 540,000 lekë

- Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (sektori i financës) pranë Bashkisë Dibër.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**PËR BASHKINË DIBËR**


P/S/Finances  
Albjola SHAHI

Drejtori Ekonomik  
Mensur SHEHI

P/S/Juridik  
Elona LUSHA

Kryetari i Bashkisë  
Rahim Spahiu

Në mungesë dhe me porosi  
Nën kryetari i Bashkisë  
Ruzhdi Deda





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

QENDRA KULTURORE DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel. 00355 218 2 25 16

Nr. 54 Prot.

Peshkopi 04/09/2023

**Lënda:** Kërkesë për mbështetje financiare për pjesëmarrjen e Qendrës Kulturore në Festivalin Folklorik Kombëtar, Gjirokastër 2023.

Mbështetur në shkresën nr. 5682/6 Prot. datë 27.10.2023 të Ministrisë së Kulturës, për fillimin e fazës përgatitore për pjesëmarrje në Festivalin Folklorik Kombëtar, Gjirokastër 2023, po ju drejtojmë kërkesën tonë për mbështetje financiare, si dhe një prevestiv paraprake lidhur me shpenzimet e nevojshme për një paraqitje dinjitoze të grupit artistik të Qendrës Kulturore Dibër.

Për realizimin e këtij projekti është i domosdoshëm ekzekutimi dhe interpretimi i këngëve të ndryshme të zgjedhura nga udhëheqësi artistik në bashkëpunim me këngëtarët dhe instrumentistët përkatës dhe interpretimi i riteve, lojrave dhe valleve të përzgjedhura nga udhëheqësi artistik dhe koreografi.

*Ky projekt bëhet në saj të promovimit të kulturës dhe vlerave artistike të Dibrës.*

Këngët që do të interpretohen janë:

- 1) Suf Murra
- 2) Hajde moj Laznore
- 3) Dibër ishe Dibër mbete
- 4) Atje n'at zabel

Vallet që do të interpretohen janë:

- 1) Valle dyshe Burrash.
- 2) Rit I jetës baritore të Kalasë së Dodës.



## Shpenzimet e mundshme

Për realizimin e këtij projekti grupi artistik do të përbëhet nga 42 persona dhe kostoja mund të jetë si më poshtë dhe sipas ligjit.

Faza e parë:

|               |                   |
|---------------|-------------------|
| Valltare      | 19x12,000=228,000 |
| Instrumentist | 15x12,000=180,000 |
| Këngëtare     | 8x12,000=96,000   |

|                             |                    |
|-----------------------------|--------------------|
| 1) Organizatorët:- Valltare | 19x12,000=228,000  |
| Instrumentist               | 15x12,000=180,000  |
| Këngëtare                   | 8x12,900=96,000    |
| Staf mbështetës             | 100,000            |
| Shpenzime operative         | 200,000            |
| Transporti                  | 201,600 mije leke. |
| <b>Gjithsej:</b>            | <b>1,509,600</b>   |

Në pritje të mbështetjes tuaj financiare!

Drejtori:

**Igli Tomcini**

